

drejtësi në tranzicionale
Parimet rajonale mbi
Parimet rajonale mbi
drejtësi në tranzicionale



parimet mbi
drejtësi në
tranzicionale

Fuqizimi i zërave gjithëpërfshirës të viktimave në Ballkanin Perëndimor

Parimet mbi drejtësinë tranzicionale për grupet e viktimave

Hyrje

Parimet mbi drejtësinë tranzicionale

Një nga rezultatet kryesore të projektit “Fuqizimi i zërave gjithëpërfshirës të viktimave” (FZGjV-SIVV) është krijimi i përbashkët i disa grupeve të parimeve nacionale të drejtësisë tranzicionale (DT) në secilin vend përkatës, domethënëse për grupet e viktimave në Maqedoni të Veriut, Serbi dhe Kosovë, si dhe në nivel rajonal.

Qëllimi kryesor ishte krijimi i parimeve të DT-së, të cilat kanë në qendër viktimat dhe janë praktike në nivelin kombëtar dhe atë rajonal në Ballkanin Perëndimor, që janë të rëndësishme për jetën e përditshme të viktimave. Objektivat specifike të parimeve janë përcaktuar në detaje në preambulë.

Është vendosur që produkti përfundimtar duhej të ishte i shkurtër, konciz dhe i qartë, duke përmbledhur vlerat dhe parimet thelbësore të viktimave. Arsyeja themelore ishte të drejtonte sjelljen, diskursin dhe komunikimin për çështjet e viktimave.

Anëtarët e Konsorciumit SIVV nga Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Kosova punuan me grupet e viktimave për të zhvilluar parime kombëtare të zbatueshme për nevojat dhe kontekstin e tyre. Një nga pyetjet kryesore të bëra në nivel kombëtar ishte: “cili është ndryshimi dhe procesi që dëshironi të shihni në të ardhmen?”

Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ - QNDT) dha komente mbi draftet fillestare dhe ofroi përvoja krahasuese për shqyrtim nga konsorciumi. Pasuan konsultime të mëtejshme në nivel terreni dhe u zhvilluan parime të rishikuara.

Më pas, ICTJ përgatiti një draft preambulë dhe konsolidoi tri grupet e parimeve kombëtare në një draft të parimeve rajonale. U identifikuan biseda kolektive, tema dhe gjëra të përbashkëta. U tregua kujdes për të përfshirë të gjitha parimet e propozuara nga niveli kombëtar, pa u futur në përsëritje.

Parimet u shqyrtuan dhe u debatuan në takimin e dytë rajonal të projektit SIVV në Prizren, që u mbajt më 20-21 maj 2023. U arrit konsensus i përgjithshëm dhe u bënë disa modifikime në draft parimet. Parimet u pranuan nga pjesëmarrësit në takim, dhe u miratuan nga Konsorciumi. Grupet individuale të viktimave janë të lira t'i adoptojnë ato zyrtarisht pasi strukturat e tyre drejtuese ose bordet t'i miratojnë ato.

Parimet tani mund të përdoren për të udhëhequr vendimet dhe zgjedhjet e grupeve të viktimave në Ballkanin Perëndimor. Ato gjithashtu mund të bëhen një platformë rreth së cilës viktimat mund të bashkohen dhe të mobilizohen për të arritur kërkesat e tyre. Sfida tani është se si të promovohen në mënyrë kuptimplote këto parime dhe si t'i bëjmë ato të praktikueshme në nivel kombëtar dhe rajonal.

Preambulë

parimet e parizësionale

Ne, grupet e viktimave të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, që synojmë të krijojmë procese kumtimplota dhe të qëndrueshme të drejtësisë tranzicionale me në qendër viktimat në vendet tona dhe në rajonin e gjerë, **njohim**:

- ▶ vuajtjet, vështirësitë dhe padrejtësitë e përjetuara nga viktimat në tërë rajonin pas konflikteve të kaluara,
- ▶ shkarjet e mëdha që kanë shkaktuar përçarje në vendet tona, si dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor,
- ▶ nevojën urgjente për:
 - të korrigjuar dëmin e pësuar nga të gjitha viktimat në rajon, dhe për të tejkaluar ndarjet e së kaluarës që vazhdojnë ende në rajonin tonë,
 - përcaktimin e garancive për ta parandaluar përsëritjen e konfliktit dhe vuajtjet që sjellë konflikti.


Të vendosur për ta mbrojtur dinjitetin e të gjitha viktimave dhe të mbijetuarve të së kaluarës sonë të dhimbshme dhe për të vepruar gjithmonë në interesin e tyre më të mirë.

Të shqetësuar nga keqtrajtimi i vazhdueshëm i viktimave dhe të mbijetuarve, dhe manipulimet e së kaluarës, dhe duke theksuar:

- ▶ zërat e padëgjuar të viktimave nga grupet e marginalizuara, veçanërisht minoritetet, gratë dhe të rinjtë,
- ▶ mbizotërimin e narrativave të njëanshme, refuzimin për të pranuar ekzistencën e viktimave nga grupet tjera etnike dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes,
- ▶ mundësinë e përhershme për dhunë dhe konflikt të mëtejshëm.

Në përputhje me rrethanat, ne miratojmë këto parime për krijimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale me në qendër viktimat në nivel kombëtar dhe rajonal, dhe:

- ▶ **Angazhohemi** për t'i zbatuar këto parime dhe për t'i respektuar vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë për të siguruar që interesat e viktimave dhe të mbijetuarve të mbrohen dhe të mos dëmtohen.
- ▶ **U bëjmë thirrje** akterëve politikë dhe publikë që t'u përmbahen këtyre parimeve dhe t'i ruajnë vlerat dhe standardet e tyre përkatëse.
- ▶ **Marrim përsipër** të veprimet me kujdesin e duhur, profesionalizmin dhe transparencën në procesin e respektimit të parimeve, dhe
- ▶ **Inkurajojmë** akterët politikë dhe publikë të veprojnë njëjtë kur kanë të bëjnë me të kaluarën, dhe veçanërisht në lidhje me diskursin dhe veprimet e tyre me viktimat.





Të gjitha viktimat

duhet të trajtohen me dinjitet

- ▶ Të gjitha viktimat, pa përjashtim, duhet të trajtohen me dhembshuri, dinjitet dhe respekt.

Viktimave duhet t'u njihen të drejtat e tyre si persona. Të gjitha viktimat kanë të drejtë për të ditur të vërtetën për sa i përket shkeljeve të së kaluarës dhe për të ditur fatin e më të dashurve të tyre. Ata kanë të drejtën e kërkimit të përgjegjësisë dhe drejtësisë, si dhe njohjen dhe kompensimin për vuajtjet e tyre. Ata gjithashtu kanë të drejtë për garanci për mospërsëritjen e shkeljeve të tilla.

Viktimave duhet t'u jepet hapësira e duhur dhe zëri i tyre të dëgjohet në një mënyrë që mbron dinjitetin e tyre.





parimet: mbi
parzëlëshiale

Çdo viktimë duhet

të njihet si e tillë

- ▶ Çdo viktimë duhet të nderohet, pa dallim. Sakrificat e çdo viktimit luftë duhet të njihet dhe respektohet, pavarësisht nga përkatësia etnike apo grupi.

Asnjë grup i vetëm nuk ka monopol mbi vuajtjet e kaluara. Minimizimi i vuajtjeve dhe humbjeve të të tjerëve duhet të ndalojë. Duhet të promovohet mirëkuptimi dhe njohja e së kaluarës së njëri-tjetrit.

Viktimat duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe duke pasur parasysh natyrën dhe shkallën e vuajtjes së tyre.





E drejta në reparacione

parimet e
parizës
në mbrojtje

- ▶ Të gjitha viktimat kanë të drejtë në reparacione efektive, duke përfshirë qasjen në shërbime të specializuara për të trajtuar dëmet fizike, mendore dhe emocionale, si dhe shkeljet e të drejtave themelore të njeriut.

Duhet të ndiqen reforma për të ofruar mbrojtje efektive ligjore për viktimat dhe familjet e tyre, duke përfshirë statusin e tyre ligjor, në mënyrë që të forcohen të drejtat e tyre për dëmshpërblim kuptimplotë.

Viktimat duhet të këshillohen për të drejtat e tyre si dhe në lidhje me mjetet juridike dhe procedurat që i kanë në dispozicion. Atyre duhet t'u sigurohen informata të përditësuara se si të kenë qasje në shërbime dhe reparacione.





Promovimi i një diskursi

publik gjithëpërfshirës për të kaluarën

- ▶ Rrëfimet për konfliktet e kaluara duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në prova dhe fakte. Rrëfimet duhet të pasqyrojnë atë që ka ndodhur. Rrëfimet e njëanshme nuk pasqyrojnë të vërtetën e plotë dhe janë të dëmshme për komunitetet.

Rrëfimet duhet të flasin për të gjitha viktimat dhe të mbijetuarit. Çdo viktimë duhet të ketë mundësi për të treguar rrëfimin e vet.

Të gjithë kanë përgjegjësi për t'i ruajtur rrëfimet nga e kaluara dhe për të siguruar që ato të dëgjohen gjerësisht e të mos mbahen të fshehura.





Qasje me bazë gjinore

parimet e
parzlesionale

- ▶ Dhuna seksuale dhe dhuna me bazë gjinore janë përdorur si armë lufte. Duhet të njihen përvojat dhe vuajtjet e grave gjatë konfliktit. Stigma dhe dëmi ndaj viktimave të shkeljeve të tilla duhet të adresohen përmes programeve konkrete. Komunitetet duhet të kujdesen për të mbijetuar të tillë. Privatësia e tyre duhet të respektohet dhe duhen trajtuar me respekt dhe dinjitet.

Gratë duhet të përfshihen në të gjitha nivelet e proceseve të drejtësisë tranzicionale. Ato jo vetëm që duhet të marrin pjesë në programe të tilla, por edhe të luajnë një rol domethënës në vendimmarrje dhe udhëheqje. Një përfshirje e tillë do të kontribuojë në krijimin e shoqërive më të drejta dhe më gjithëpërfshirëse në rajon.





Memorializimi duhet

të jetë gjithëpërfshirës

- ▶ Memorializimi dhe përkujtimet duhet t'i pasqyrojnë sakrificat dhe përvojat e të gjitha komuniteteve, dhe duhet të jenë të bazuara në fakte. Memorialet nuk duhet të kufizohen vetëm në programe monoetnike, por aty ku është e mundur duhet të tejkalojnë ndarjet etnike dhe fetare. Duhet të shqyrtohet me kujdes konteksti për të siguruar që nevojat lokale, traditat dhe aspektet socio-kulturore të respektohen.

Memorialet duhet të jenë produkt i pjesëmarrjes popullore me përfshirjen e të rinjve. Aktivitetet përkujtimore duhet të synojnë promovimin e dialogut ndërmjet brezave dhe shkëmbimin social ndërmjet komuniteteve. Qëllimi final i përkujtimit duhet të jetë rikthimi dhe afirmimi i të drejtave të shkelura dhe dinjitetit për kujtimet e viktimave dhe të mbijetuarve.

Ngjarjet e së kaluarës duhet të përkujtohen në një mënyrë që nuk i thellojnë ndarjet në mes komuniteteve. Memorialet nuk duhet të fokusohen vetëm te figurat zyrtare dhe luftëtarët, por edhe te viktimat civile, të cilët duhet respektuar.





Kërkimi i së vërtetës së paanshme, informimi dhe edukimi i publikut

- ▶ Është e nevojshme gjetja rigoroze dhe e paanshme e fakteve të konflikteve të së kaluarës, së bashku me analiza të hollësishme për të nxjerrë konkluzione të besueshme dhe objektive. Duhet të ketë bashkëpunim rajonal për të siguruar qasje të papenguar në të gjithë informacionin përkatës.

Duhet të shmangen interpretimet e njëanshme. Në kërkim të së vërtetës duhet të dëgjohen të gjitha palët dhe perspektivat. Duhet të analizohet e kaluara me të gjitha ndërlikimet dhe nuancat e saj. Duhet të theksohen përvojat personale nga të gjitha palët.

Faktet e konfirmuara duhet të vihen në dispozicion dhe të jenë të qasshme për publikun, të përmbliidhen me saktësi dhe kur është e nevojshme të përkthehen në gjuhë të ndryshme. Informacioni i mbledhur duhet të ruhet në arkiva dhe të bëhet i qasshëm për publikun.





Të trajtohet me prioritet

kërkimi i personave të zhdukur

- ▶ Duke pasur parasysh paqartësinë në cilën jetojnë familjarët, çështjes së personave të zhdukur duhet t'i jepet prioritet në agjendat politike në të gjithë rajonin. Të gjitha përpjekjet duhet të fokusohen për të zbardhur fatin e personave të zhdukur dhe për gjetjen dhe identifikimin e mbetjeve të tyre.

Duhet të ketë bashkëpunim rajonal ndërmjet shteteve dhe grupeve të viktimave për të koordinuar kërkimin e personave të zhdukur dhe kthimin e eshtrave të familjet.





E drejta për t'u kthyer

parimet mbi
parzeshënale

- ▶ Personat e zhvendosur janë një grup viktimash shpesh të lënë anash. Duhet të garantohet e drejta e tyre për t'u kthyer, e cila përfshin krijimin e një mjedisi të sigurt dhe kthimin apo kompensimin e drejtë për pronat e tyre.





Përfshirja e të rinjve

parimi i
parzësonale

- ▶ Duhet të hulumtohen mënyra inovative për t'i informuar dhe edukuar të rinjtë për t'iu mundësuar atyre që të mendojnë në mënyrë kritike dhe konstruktive për të kaluarën.

Shoqatat e viktimave duhet të përfshijnë sa më shumë të rinj në aktivitetet e tyre që të sigurojnë që zërat e tyre të dëgjohen në proceset e drejtësisë tranzicionale dhe të ndërtimit të paqes.

Duhet të krijohen mundësi që të rinjtë nga komunitete të ndryshme të përfshihen në dialogun ndërkomunitar, në projekte kulturore e sociale dhe programe shkëmbimi për të rritur mirëkuptimin dhe respektin e ndërsjellë.





parimet mbi
parzësonale

Avokimi i përbashkët

për kauzat e viktimave

- ▶ Viktimat duhet të bashkohen dhe të mobilizohen së bashku rreth qëllimeve të përbashkëta. Avokimi i përbashkët ka ndikim më të madh në institucionet publike dhe shoqërinë. Kërkesat e viktimave merren më seriozisht kur bëhen bashkë. Bashkëpunimi gjithashtu ndërton solidaritet midis grupeve të viktimave.

Organizatat e viktimave duhet ta zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre dhe të synojnë të ndërtojnë një front të bashkuar mbi kërkesat kryesore të viktimave.





parimetimi
parizeshore

Grupet e viktimave

nuk duhet të instrumentalizohen

- ▶ Të mbijetuarit dhe grupet e viktimave nuk duhet ta lejojnë veten të instrumentalizohen nga palët politike ose grupet e tjera të interesit për qëllime keqdashëse ose të fshehta.

Grupet e viktimave duhet të përpiqen të jenë të hapura dhe transparente në vendimmarrjen e tyre. Përfaqësuesit e viktimave duhet çdo herë të veprojnë me integritet.

Anëtarët dhe organizatat duhet të mbahen të informuar për zhvillimet kryesore. Ata duhet të ndihmohen që të angazhohen në pjesëmarrje domethënëse në vendimet dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me ta.





Të drejtat e privatësisë së

viktimave duhet të respektohen

- ▶ Rrëfimet e viktimave u përkasin vetëm atyre. Ato nuk mund të shpërndahen ose publikohen pa pëlqimin e tyre paraprak.

U takon viktimave të vendosin se cilat detaje të përvojave të tyre mund të publikohen. Viktimat mund të vendosin të ndalojnë zbulimin e identitetit të tyre. Viktimat kanë të drejtë të kërkojnë konfidencialitet të plotë, me ç'rast të drejtat e tyre për privatësi duhet të respektohen gjatë gjithë kohës.





Gjuha e urrejtjes

duhet të eliminohet

- ▶ Gjuha e urrejtjes nxit dhunë dhe rikthim të konfliktit. Kjo e poshtëron dinjitetin dhe humanizmin e njerëzve dhe është kërcënim për vetë demokracinë.

Përfaqësuesit e grupeve të viktimave duhet ta shmangin diskursin nacionalist dhe etnik.

Diskursi që promovon ndëshkimin kolektiv ose ia atribuon fajin kolektiv grupeve ose komuniteteve etnike duhet të ndalet. Vetëm individët apo institucionet që kanë kryer apo urdhëruar krime duhet të mbajnë përgjegjësi dhe vetëm pasi të jenë kontrolluar dhe verifikuar faktet.





Ndërtimi i besimit

parimet e
parzlesishme
të bashkëpunimit

- ▶ Shoqëritë duhet të ofrojnë hapësira të sigurt për njerëzit që ta dëgjojnë palën “tjetër”. Duhet të inkurajohet një kulturë e përkujtimit dhe tolerancës e përcjellur me respekt në të cilën komunitetet janë të gatshme të dëgjojnë këndvështrime dhe interpretime të ndryshme. Krimet e luftës dhe kriminelët e dënuar të luftës nuk duhet të glorifikohen.

Vetëm duke trajtuar padrejtësitë e së kaluarës në një mënyrë kaq konstruktive mund të vendoset baza për ndërtimin e një vizioni për një të ardhme të përbashkët në rajon.





Paqe e qëndrueshme

parimi i
parizës në
paqe

- ▶ Paqja e qëndrueshme në rajon dhe ndërmjet komuniteteve është parakusht për rindërtimin e jetëve. Kjo përfshin jo vetëm ndërprerjen e armiqësive, por edhe largimin e frikës nga ripërtëritja e konfliktit ose dhunës.

Shoqatat e viktimave duhet të kërkojnë respekt të plotë të të drejtave të njeriut dhe kjo mundëson vendosjen e garancisë për mospërsëritjen e konfliktit. Kjo përfshin respektimin e parimeve të përcaktuara në këtë dokument. Për këtë, gjithashtu kërkohet dialog i thellë brenda rajonit në nivele të ndryshme. Institucionet publike që dikur kanë qenë abuzive duhet të reformohen ose ristrukturohen.

Vlerat që promovojnë tolerancën, mirëkuptimin dhe respektin e dinjitetit njerëzor duhet të promovohen në tërë rajonin.





Iniciativat Qytetare (Gradjanske inicijative): Iniciativat Qytetare është një organizatë e shoqërisë civile e cila për tashmë 25 vjet punon në edukimin e qytetarëve për të drejtat e tyre, demokracinë, shoqërinë civile dhe në atë se si të jenë qytetarë aktivë dhe të barabartë në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre. Vizioni i organizatës "Iniciativat Qytetare" është një shoqëri e drejtë e qytetarëve të vetëdijshëm për përgjegjësitë dhe rolin e tyre, shoqëri aktive dhe e zëshme në dialog të vazhdueshëm me një shtet të hapur dhe të përgjegjshëm. <https://www.gradjanske.org>



Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (International Center for Transitional Justice ICTJ): ICTJ punon krah për krah me viktimat për të arritur njohjen dhe korrigjimin e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, për të kërkuar llogari nga ata që janë përgjegjës, për të reformuar dhe ndërtuar institucione demokratike dhe për të parandaluar përsëritjen e dhunës ose shtypjes. <https://www.ictj.org>



OJQ Integra: Misioni i Integra-s është të ndihmojë zhvillimin e Kosovës, veçanërisht në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe integritit, duke trajtuar dhe promovuar rrëfime dhe përvoja të komuniteteve të marginalizuara, duke kontribuar kështu në proceset demokratike, ndërtimin e besimit dhe bashkëjetesës paqësore. <https://www.ngo-integra.org>



Iniciativa e Re Sociale (NSI): NSI është një organizatë e shoqërisë civile që fuqizon komunitetet joshumicë për të marrë pjesë në jetën shoqërore dhe institucionale të Kosovës dhe rrit besimin në mes të komuniteteve duke i mbështetur ata që të merren me të kaluarën dhe të normalizojnë marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. <https://newsocialinitiative.org/>



Aksioni Paqësor (Mirovna akcija): Aksioni Paqësor është një organizatë jofitimprurëse e aktivistëve që punon në ndërtimin e paqes dhe promovimin e kulturës së mosdhunës përmes inicimit dhe edukimit të dialogut konstruktiv, duke u marrë me të kaluarën, arsimin e integruar dhe bashkëpunimin rajonal. <https://mirovnaakcija.org>



PAX: PAX është organizata më e madhe e paqes në Holandë. Ajo punon për të mbrojtur civilët nga aktet e luftës, për t'i dhënë fund dhunës së armatosur dhe për të ndërtuar paqen gjithëpërfshirëse. PAX punon në zona konflikti në mbarë botën me partnerë lokalë dhe njerëz të cilët, ngjashëm, besojnë se secili ka të drejtën për një jetë dinjitoze në një shoqëri paqësore. <https://paxforpeace.nl>



Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit "Fuqizimi i zërave gjithëpërfshirës të viktimave, transformimi i narrativave", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e konsorciumit të projektit, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



2023.

parimet mbi
dretësinë
transicionale